

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Drejtoria Rajonale e Ofrimit të Formimit Profesional Publik Nr. 4 Tiranë

PROGRAMI

I KURSIT TË VEÇANTË

“GRAFIK DIZAJN”

Kodi: GD-19

Miratoi

DREJTOR

.....

Tiranë, 2019

PROGRAMI I KURSIT TË VEÇANTË

“GRAFIK DIZAJN”

(Kodi: GD-19)

I. Profili Profesional i Dizenjuesit Grafik.

a) Karakteristikat e dizenjuesit grafik.

Dizenjuesi grafik do të jetë i aftë të kryejë detyra profesionale si i punësuar në studio grafike apo si freelancer(punë e pavaraur).

Për realizimin me sukses të këtyre detyrave, dizenjuesi grafik duhet që të zotërojë njohuri profesionale që kanë të bëjnë me konceptet dhe procedurat bazë që lidhen me veprimtarinë profesionale të dizenjuesit grafik. Realizim me sukses i detyrave konsiderohet dhe fakti që, kursantët në fund të kursit duhet të pajisjen me portofolin e tyre profesional që demonstroi krijimin dhe origjinalitetin në punët grafike, i cili do t'u shërbejë për punësim.

Suksesi i dizenjuesit grafik është i lidhur ngushtë dhe me **sjellje** (qëndrime) të tilla si: kreativiteti, shkathtësia, përqëndrimi, korrektësia, durueshmëria, disiplina etj., sjellje që e ndihmojnë atë të plotësojë kërkesat dhe përballojë vështirësitë e punës.

b) Mundësitë e punësimit dhe karriera profesionale e dizenjuesit grafik.

Profesioni i dizenjuesit grafik është i lidhur ngushtë me procedurat e punës në lidhje me krijimin e koncepteve vizuale dhe krijimin e dizajneve për reklamim ose informim si: logo, fletëpalosje, kartëvizita, postera, banera, broshura, revista, gazeta dhe libra, të cilat printohen ose për publikim dixhital. Ai mund të punësohet në studio grafike si "junior designer" (2D), ose të punojë si 'freelancer'.

Me përvojë pune dhe me kualifikime shtesë mund të përparojë profesionalisht në nivelin e "senior designer"(2D-3D), dizenjues grafik mund të ndërmarrë disa funksione mbikëqyrëse duke ngritur shkallët e karrierës si drejtues dizajneri kreativ.

Përfundimi me sukses i këtij kualifikimi i jep mundësi kursantit të kalojë ose të zhvillohet në profesione të tjera që kanë të bëjnë me dizenjimin grafik si, web dizajn , art dizajn, inxhinieri dizajn e etj., sigurisht këto kërkojnë përvojë pune dhe kualifikime të mëtejshme dhe shkollim përkatës.

II. Kompetencat që fitojnë kursantët në përfundim të Kursit për “Grafik Dizajn”.

Në përfundim të Kursit për Grafik Dizajn, kursantët do të jenë të aftë të:

- bëjnë kërkime në internet rreth dizajneve që do të krijojnë;
- përdorin mjetet dhe veglat e programeve (photoshop, *illustrator dhe indizajn*);
- përshtatin përmasat e dizajnit sipas kërkesës së klientit;
- aplikojnë dizajne mbi formate të ndryshme(modifikojnë “mockup”);
- përdorin teknika të efektshme për retushimin, korrektimin , transformimin e imazheve fotografike në photoshop;
- manipulojnë ngjyrat dhe ruajnë kodet e ngjyrave në dizajnet grafike;
- aplikojnë dhe instalojnë lloje të ndryshme fondesh për dizajnet grafike;
- përdorin terminologjinë e nevojshme për principet dhe elementet e dizajnit, për ngjyrat, rezolucionin, shkrimin e etj.;
- dizenjojnë logo/brand identiteti për print ose publikim dixhital;
- dizenjojnë produkte për reklamim (kartëvizita, fletëpalosje, kalendarë, postera, banera, broshura, e etj., për printim ose publikim dixhital;

- bëjnë faqosjen e gazetës , revistës dhe librit në indizajn;
- rishikojnë dizajnin për gabime para se të printohet ose publikim dixhital;
- përshkruajnë përbërjen e materialeve në të cilat aplikohet dizajni(tekstil, plastik, leter, adeziv, dru, qelq, qeramik, etj);
- përgatisin portofolin profesional;
- kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike për punën e kryer;
- komunikojnë në mënyrë korrekte dhe prezantojnë dizajne të ndryshme klientëve.

III. Kërkesat e pranimit në Kursin për “Grafik Dizajn”.

Pjesëmarrësit në Kursin “Grafik Dizajn” duhet të jenë mbi 18 vjeç, të kenë përfunduar arsimin e mesëm.

IV. Kohëzgjatja e Kursit për “Grafik Dizajn”.

250 orë mësimore, ku
1 orë mësimore = 45 minuta

V. Modulet e Kursit për “Grafik Dizajn”.

Nr.	Titulli i Modullit	Kodi	Kohëzgjatja	Rezultatet Mësimore
1	Hyrje në profesionin e dizenjuesit grafik.	GD-01-19	20 orë mësimore Rekomandohet: 60% Teori 30% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të dizenjuesit grafik. 2. Kursanti përshkruan llojet dhe veçoritë e dizajneve në programet përkatëse. 3. Kursanti përdor burime dizajni që e frymëzojnë për krijim.
2	Editimi, transformimi dhe retushimi i imazheve në fotoshop	GD -02-19	20 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përgatit mjedisin e punës për editim, transformim dhe retushim të imazhe në fotoshop. 2. Kursanti transformon, editon dhe retushon imazheve në fotoshop.
3	Dizenjimi i produkteve për reklamim në ilustrator.	GD -03-19	110 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përgatit mjedisin e punës për të dizenuar logon, kartëvizita, fletëpalosje, kalendare, postera, banera, broshura e etj.. 2. Kursanti dizenjon logo në ilustrator. 3. Kursanti dizenjon kartëvizita në ilustrator. 4. Kursanti dizenjon fletëpalosjen në ilustrator. 5. Kursanti dizenjon postera dhe banera në ilustrator. 6. Kursanti dizenjon broshura në ilustrator. 7. Kursanti dizenjon kapakun e librit dhe revistes në ilustrator.

4	Faqosja e gazetës, revistës dhe librit në indizajn.	GD -04-19	90 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti parapërgatit mjedisin e punës në indizajn. 2. Kursanti kryen faqosjen e gazetës në indizajn. 3. Kursanti kryen faqosjen e revistës në indizajn. 4. Kursanti kryen faqosjen e librit në indizajn.
5	Përgatitja e portofolit profesional.	GD -05-19	10 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan vecoritë e përgatitjes së portofolit profesional. 2. Kursanti përgatit portofolin profesional.

VI. Vlerësimi dhe Çertifikimi

Kursantët vlerësohen nga instruktorët e Kursit për të gjitha Rezultatet Mësimore që përmbajnë të gjitha Modulet e Kursit dhe nëse vlerësohen pozitivisht, futen në Provimin përfundimtar teoriko-praktik.

Nëse vlerësohen pozitivisht edhe në Provimin përfundimtar teoriko-praktik, kursantët fitojnë Çertifikatën përkatëse që njihet nga MFE.

VII. Përshkruesit e Moduleve të Kursit “Grafik Dizajn”:

1. Moduli “Hyrje në profesionin e dizenjuesit grafik”

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	HYRJE NE PROFESIONIN E DIZENJUESIT GRAFIK.	GD-01-19
Qëllimi i modulit	Një modul teoriko – praktik që i njeh kursantët me veçoritë e profesionit të dizenjuesit grafik, me llojet dhe veçoritë e dizajneve dhe programeve, si dhe me përdorimin e burimeve online të dizajneve grafike.	
Kohëzgjatja e modulit	20 orë mësimore Rekomandohet: 60% Teori; 30% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e mesëm, të jenë mbi 18 vjeç.	

**Rezultatet e të
mësuarit (RM),
dhe procedurat
e vlerësimit**

RM 1 Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të dizenjuesit grafik.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë funksionet, detyrat dhe veprimtaritë kryesore të punës të dizenjuesit grafik;
- të përshkruajë mjediset, mënyrën e organizimit dhe kushtet e punës të dizenjuesit grafik;
- të përshkruajë kërkesat profesionale të dizenjuesit grafik;
- të përshkruajë mundësitë e punësimit të dizenjuesit grafik;
- të shpjegojë mundësitë e karrierës profesionale të dizenjuesit grafik;
- të përshkruajë rregullat e komunikimit me etikë profesionale gjatë punës së dizenjuesit grafik.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje- përgjigje me gojë.
- Pyetje -përgjigje me shkrim.

RM 2 Kursanti përshkruan llojet dhe veçoritë e dizajneve në programet përkatëse.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë llojet dhe veçoritë e dizajneve që do të zhvillohen në programe;
- të përshkruajë rëndësinë dhe përdorimet e dizajneve;
- të përshkruajë veçoritë e programeve në të cilat zhvillohen projektet;
- të përdorë terminologjinë e duhur për programet përkatëse;
- të përshkruajë programet që përdoren për dizajn grafik;
- të përshkruajë veçoritë e materialeve mbi të cilat do të aplikohet dizajni.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

RM 3 Kursanti përdor burime dizajni që e frymëzojnë për krijim.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përdorë burime frymëzimi mbi dizenjuesit historik dhe bashkëkohorë;
- të prezantojë profesione të ndryshme që përfshihen dhe lidhen me profesionin e dizenjuesit grafik;
- të përdorë burime grafike të duhura të dizenjimit grafik.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Pyetje - përgjigje me shkrim

Udhëzime për zbatimin e modulit	- Ky modul duhet të trajtohet në kabinetin kompjuterik dhe në mjediset e punës të një studio grafike. - Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete. - Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete me mjediset e punës, mjetet e punës, komunikimin dhe kërkimin në internet etj. - Atyre duhet t'u jepen detyra mbi veçoritë e profesionit të dizenjuesit grafik, për funksionet, detyrat dhe veprimtaritë ku mbështetet puna e dizenjuesit grafik. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë. - Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: - Kabinet kompjuterik i pajisur me mjete dhe materiale pamore. - Kompjuter, programe, internet. - Mjedisë reale të punës. - Kataloge, rregullore, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

2. Moduli “Editimi, transformimi dhe retushimi i imazheve në fotoshop”

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	EDITIMI, TRANSFORMIMI DHE RETUSHIMI I IMAZHEVE NË FOTOSHOP.	GD -02-19
Qëllimi i modulit	Një modul teoriko-praktik që njeh kursantët me mjedisin e punës në fotoshop, si dhe i aftëson ata për të edituar, transformuar dhe retushuar imazhe në fotoshop.	
Kohëzgjatja e modulit	20 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e mesëm, të jenë mbi 18 vjeç, të kenë kryer Modulin 1 “Hyrje në profesionin e dizenjuesit grafik”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti përgatit mjedisin e punës për editim, transformim dhe retushim të imazheve në fotoshop. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë mjedisin e punës në fotoshop;	

-
- të përshkruajë funksionin e programit fotoshop;
 - të shpjegojë përdorimin e mjeteve dhe veglave bazike që përdoren për editim të fotove në programin fotoshop;
 - të shpjegojë përdorimin e mjeteve bazike që përdoren për transformim e fotove në programin fotoshop;
 - të demonstrojë përdorimin e mjeteve bazike që përdoren për retushimin e fotove në programin fotoshop;
 - të demonstrojë përdorimin e mjeteve bazike që përdoren për korrektimin e fotove në programin fotoshop;
 - të përshkruajë shtresat(layerat) e një punimi;
 - të shpjegojë rëndësinë që ka përdorimi i patheve;
 - të bëjë kërkime në internet rreth fotove që do transformohen;
 - të përdorë terminologjinë e duhur për: principet, elementet, ngjyrat, rezolucionin, shkrimin e dizajnit;
 - të instalojë programin fotoshop.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Pyetje - përgjigje me shkrim

RM 2 Kursanti transformon, editon dhe retushon imazhe në fotoshop.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të analizojë imazhet që do të zhvillojë në fotoshop;
- të hapë një dokumkent të ri me rezolucionin e duhur në fotoshop;
- të importojë imazhe në fotoshop;
- të përzgjedhë veglat dhe mjetet e duhura për editimin transformimin dhe retushimin e imazheve në fotoshop
- të organizojë shtresat(layers) e një punimi;
- të përdorë metodat e duhura për ngjyrimin e imazheve me ngjyra dhe bardhë e zi;
- të përdorë Mask-ën për shkrirjen e imazheve te ndryshme në një të vetëm;
- të rishikojë dhe të korrigjojë imazhin para se të printohet ose publikohet;
- të ruajë imazhin për print ose publikim dixhital;
- të respektojë standartet e krijimit te imazhit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit	- Ky modul duhet të trajtohet në kabinetin kompjuterik. - Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet e ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete. - Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në fotoshop, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. - Atyre duhet ti jepen detyra për editimin, transformimin dhe retushimin e fotove. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë. - Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, programet, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: - Kabinet kompjuterik i pajisur me mjete dhe materiale pamore. - Programet dhe internet. - Kataloge, rregullore, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

3. Moduli “Dizenjimi i produkteve për reklamim në ilustrator”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	DIZENJIMI I PRODUKTEVE PËR REKLAMIM NË ILUSTRATOR.	GD -03-19
Qëllimi i modulit	Një modul teoriko-praktik që i njeh kursantët me veçoritë e mjedisit të punës në ilustrator, si dhe i aftëson ata të dizenjojnë logo, kartëvizita, fletëpalosje, kalendare, postera, banera, broshura e etj., duke respektuar teknikat dhe parimet e dizenjimit.	
Kohëzgjatja e modulit	110 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e mesëm, të jenë mbi 18 vjeç, të kenë kryer Modulin 1 “Hyrje në profesionin e dizenjuesit grafik”; Modulin 2 “Editimi, transformimi dhe retushimi i imazheve në fotoshop”.	

**Rezultatet e të
mësuarit (RM),
dhe procedurat
e vlerësimit**

RM 1 Kursanti përgatit mjedisin e punës për të dizenuar logo, kartëvizita, fletëpalosje, kalendare, postera, banera, broshura, etj..

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë mjedisin e punës në ilustrator;
- të demonstroi përdorimin e mjeteve dhe veglave bazike, për të dizenuar logo, fletëpalosje, kartëvizita, kalendare, postera, banera, broshura;
- të shpjegojë formatet dhe njësitë matëse për të dizenuar logo, fletëpalosje, kartëvizita, kalendare, postera, banera, broshura;
- të përdorë terminologjinë e duhur për principet dhe elementet e dizajnit për krijimin e produkteve;
- të instalojë programin ilustrator.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Pyetje - përgjigje me shkrim

RM 2 Kursanti dizenuon logo në ilustrator.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë llojet dhe vecoritë e logove;
- të tregojë rëndësinë e përdorimit të logove;
- të bëjë kërkime në internet rreth logove që do të dizenuojë;
- të bëjë analizë rreth logove që do të dizenuojë;
- të aplikojë dizajnin e logos mbi formate të ndryshme(modifikime mockup);
- të përdorë mjetet dhe veglat e punës për dizenuimin e logos;
- të përpunojë dhe pozicionojë logon në mënyrë të saktë, në ilustrator;
- të përdorë mjetet për shkrimin e ngjyrave gjatë dizenuimit të logos, në ilustrator;
- të aplikojë lloje të ndryshme fontesh për krijimin e logos, në ilustrator;
- të bëjë strukturimin, modifikimin e logos në ilustrator;
- të rishikojë logon para se të publikohet ose të printohet;
- të ruajë kodet e ngjyrave të dizajnit të logos, para se të publikohet ose të printohet;
- të përshkruajë përbërjen e materialeve në të cilat aplikohet/printohet logo(tekstil, plastik, letër adeziv, qelq, qeramik, e etj.);
- të aplikojë mockup-e në objekte të ndryshme;
- të përshtasin logot sipas kërkesës së klientit;
- të respektojnë standartet për krijimin e logove;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike për punën e kryer;
- të komunikojë në mënyrë korrekte dhe të prezantojë dizajnin klientit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 3 Kursanti disenjon kartëvizita në ilustrator.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë llojet dhe vecoritë e kartëvizitave;
- të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të kartëvizitave;
- të bëjë kërkime në internet rreth kartëvizitave që do të disenjojë;
- të analizojë kartëvizitat që do të disenjojë;
- të përdorë mjetet dhe veglat e punës për dizenjimin e kartëvizitave, në ilustrator;
- të përpunojë dhe pozicionojë kartëvizitën në mënyrë të saktë, në ilustrator;
- të përdorë mjetet për shkrirjen e ngjyrave gjatë dizenjimit të kartëvizitës në ilustrator;
- të aplikojë lloje të ndryshme fontesh për dizenjimin e kartëvizitës, në ilustrator;
- të bëjë strukturimin, modifikimin e kartëvizitës në ilustrator;
- të rishikojë kartëvizitën para se të publikohet ose të printohet;
- të ruajë kodet e ngjyrave të dizajnit të kartëvizitës, para se të publikohet ose të printohet;
- të përshkruajë përbërjen e materialeve në të cilat aplikohet/printohet kartëvizita (plastik, letër adeziv, leter me relief, metal e etj.);
- të përshtatë kartëvizitën sipas kërkesës së klientit;
- të respektojë standartet për krijimin e kartëvizitës;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike për punën e kryer;
- të komunikojë në mënyrë korrekte dhe prezantojë dizajnin klientit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 4 Kursanti disenjon fletëpalosjen në ilustrator.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë llojet dhe vecoritë e fletëpalosjeve, përdorimi dhe rëndësia e tyre;
- të bëjë kërkime në internet rreth fletëpalosjeve që do të disenjojë;
- analizojë fletëpalosjen që do të disenjojë;
- të përdorë mjetet dhe veglat e punës për dizenjimin e fletëpalosjes;
- të pozicionojë shtresat(layerat) në mënyrë të saktë, në ilustrator;
- të përdorë mjetet për shkrirjen e ngjyrave gjatë

- dizenjimit të fletëpalosjes, në ilustrator;
- të aplikojë lloje të ndryshme fontesh për dizenjimin e fletëpalosjes, në ilustrator;
- të bëjë strukturimin, modifikimin e fletëpalosjes në ilustrator;
- të rishikojë fletëpalosjen para se të printohet;
- të ruajë kodet e ngjyrave të dizajnit të fletëpalosjes, para se të publikohet ose të printohet;
- të përshkruajë përbërjen e materialeve në të cilat aplikohet/printohet fletëpalosja(plastik, leter, etj.);
- të përshtatë fletëpalosjen sipas kërkesës së klientit;
- të respektojë standartet për krijimin e fletëpalosjes;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike për punën e kryejë;
- të komunikojë në mënyrë korrekte dhe prezantojë dizajnin klientit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 5 Kursanti dizenjon postera dhe banera në ilustrator.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë llojet dhe vecoritë e posterave dhe banerave;
- të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të banerave dhe posterave;
- të bëjë kërkime në internet rreth banerave dhe posterave që do të dizenjojë;
- të analizojë banera dhe postera që do të dizenjojë;
- të përdorë mjetet dhe veglat e punës për dizenjimin e banerit dhe posterit në ilustrator;
- të pozicionojë shtresat(layerat) e punimit në mënyrë të saktë, në ilustrator;
- të përdorë mjetet për shkrimin e ngjyrave gjatë dizenjimit të banerit dhe posterit, në ilustrator;
- të aplikojë lloje të ndryshme fontesh për dizenjimin e banerit dhe posterit, në ilustrator;
- të bëjë strukturimin, modifikimin e banerit dhe posterit, në ilustrator;
- të rishikojë banerin dhe posterin përpara se të printohet ose publikohet;
- të ruajë kodet e ngjyrave të dizajnit të banerit dhe posterit, para se të publikohet ose të printohet;
- të përshkruajë përbërjen e materialeve në të cilat aplikohet/printohet baneri(plastik, leter, adeziv, e etj.);
- të përshtatë banerin dhe posterin sipas kërkesës së klientit;
- të aplikojë dizajnin mockup-e në objekte të ndryshme;
- të respektojë standartet për krijimin e banerit dhe posterit;

- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike për punën e kryer;
- të komunikojë në mënyrë korrekte dhe të prezantojë dizajnin klientit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 6 Kursanti dizenjon broshura në ilustrator.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë llojet dhe veçoritë e broshurave;
- të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të broshurave;
- të bëjë kërkime në internet rreth broshurave që do të dizajnojnë;
- të analizojë rreth broshurave që do të dizajnojnë;
- të përdorë mjetet dhe veglat e punës për dizajnimin e broshurës, në Ilustrator;
- të pozicionojë shtresat(layerat) e broshurës, në ilustrator;
- të përdorë mjetet për shkrimin e ngjyrave gjatë dizajnimit të broshurave, në ilustrator;
- të aplikojë lloje të ndryshme fontesh për dizajnimin e broshurës, në ilustrator;
- të bëjë strukturimin, modifikimin e broshurës në ilustrator;
- të rishikojë broshurën para se të printohet;
- të ruajë kodet e ngjyrave të dizajnit të broshurave, para se të publikohet ose të printohet;
- të përshkruajë përbërjen e materialeve në të cilat aplikohet/printohet broshura (letër, karton e etj.);
- të përshtatë broshurën sipas kërkesës së klientit;
- të respektojë standartet për krijimin e broshurës;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike për punën e kryer;
- të komunikojë në mënyrë korrekte dhe prezantojë dizajnin klientit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 7 Kursanti dizenjon kapakun e librit dhe revistës në ilustrator.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë llojet dhe veçoritë e kapakëve të librit dhe revistës;
- të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të kapakut të librit dhe revistës;
- të bëjë kërkime në internet rreth kapakeve të librave dhe revistave që do të dizajnojnë;

- të bëjë analizë rreth kapakeve që do të dizajnojnë;
- të përdorë mjetet dhe veglat e punës për dizajnimin e kapakeve të librit dhe revistës, në ilustrator;
- të pozicionojë shtresat(layerat) e punimit në mënyrë të saktë, në ilustrator;
- të përdorë mjetet për shkrimin e ngjyrave gjatë dizajnit të kapakëve të librit dhe revistës , në ilustrator;
- të aplikojë lloje të ndryshme fontesh për dizajnimin kapakut të librit dhe revistës, në ilustrator;
- të bëjë strukturimin, modifikimin e kapakut të librit dhe revistës në ilustrator;
- të rishikojë kapakun para se të printohet;
- të ruajë kodet e ngjyrave të dizajnit të kapakëve të librit dhe revistës, para se të printohet;
- të përshkruajë përbërjen e materialeve në të cilat aplikohet/printohet kapaku i revistës dhe librit (letër, karton e etj.);
- të përshtatë kapakun sipas kërkesës së klientit;
- të respektojë standartet për krijimin e kapakut të librit dhe revistës;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike për punën e kryer;
- të komunikojë në mënyrë korrekte dhe prezantojë dizajnin klientit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në kabinetin kompjuterik.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në ilustrator, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur.
- Atyre duhet ti jepen detyra për të dizajnuar logo, kartëvizita, fletëpalosje, kalendare, postera, banera, broshura e etj.. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me projektet që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Mjedise reale të punës.
 - Kompjuter, programe, internet.

- Kataloge, rregullore, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

4. Moduli “Faqosja e gazetës, revistës dhe librit në indizajn”

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	FAQOSJA E GAZETËS, REVISTËS DHE LIBRIT NË INDIZAJN.	GD -04-19
Qëllimi i modulit	Një modul teoriko- praktik që i njeh kursantët me veçoritë dhe përdorimin e mjeteve të punës në indizajn, si dhe i aftëson ata në faqosjen e gazetës, revistës dhe librit, në kryerjen e veprimeve bazë të përpunimit të tekstit, për punimet me paragrafet e tekstit, me imazhet dhe objektet në indizajn.	
Kohëzgjatja e modulit	90 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e mesëm, të jenë mbi 18 vjeç, të kenë kryer Modulin 1 “Hyrje në profesionin e dizenjuesit grafik”; Modulin 2 “Editimi, transformimi dhe retushimi i imazheve në fotoshop”; Modulin 3 “Dizenjimi i produkteve për reklamim në ilustrator”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti parapërgatit mjedisin e punës në indizajn. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të pëshkruajë mjedisin e punës në indizajn; - të përshkruajë rregullat teknike të dizenjimit në indizajn; - të pëshkruajë parimet e dizenjimit në indizajn; - të shpjegojë përdorimin e mjeteve dhe veglave të punës në indizajn; - të demonstrojë përdorimin e paletave; - të demonstrojë veprimet bazë në përpunimin e tekstit; - të demonstrojë veprimet bazë në punimet me paragrafet e tekstit; - të përshkruajë stilet e veçanta të paragrafeve dhe objekteve. - të përshkruajë shtresat e një punimi (layerat). - të demonstrojë veprimet bazë në manipulimin e ngjyrave; - të përshkruajë objektet që dizenjohen në indizajn. - të instalojë programin indizajn. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje - përgjigje me gojë - Pyetje - përgjigje me shkrim	

RM 2 Kursanti kryen faqosjen e gazetës në indizajn.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë llojet dhe vecoritë e gazetave;
- të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të gazetave;
- të bëjë kërkime në internet rreth gazetave që do të dizenjojnë;
- të bëjë analizë rreth gazetës që do të dizenjojnë;
- të krijojë një publikim të ri;
- të hapë dokumentat e duhura për dizajnimin e gazetës;
- të përdorë kutinë e mjeteve të punës;
- të përdorë paletat e kontrollit;
- të menaxhojë paletat e kontrollit;
- të përdorë guidat e vizoreve;
- të përdorë guidat e anëve dhe kolonave;
- të bëjë zmadhimin dhe zvogëlimin e figurës;
- të bëjë zhvendosjen e figurës;
- të anullojë veprimet kur është e nevojshme;
- të përdorë të gjitha komandat e duhura për formatimin e tekstit;
- të kryejë veprimet bazë për përpunimin e tekstit;
- të strukturojë paragrafet e tekstit;
- të përdorë stilet e veçanta të paragrafeve dhe objekteve;
- të vendosë imazhe në objekte;
- të kryejë veprime të tjera të menaxhimit të shtresave (ndryshimi i radhës së mbivendosjes, grupimi, radhitja dhe shpërndarja e objekteve);
- të punojë me ngjyrat në Indizajn për dizajnimin e gazetës (përdorimi i paletës Swatches, mostrat, përdorimi i paletës së ngjyrave, përdorimi i katalogëve të ngjyrave të gatshme, krijimi dhe aplikimi i gradienceve);
- të punojë me faqet Master;
- të bëjë strukturimin përfundimtar të faqes në indizajn;
- të vendosë numrin e faqeve dhe përmbajtjen e gazetës me anë të faqeve Master;
- të rishikojë gazetën para se të printohet;
- të ruajë kodet e ngjyrave të dizajnit të gazetës para se të printohet;
- të përshkruajë përbërjen e materialeve në të cilat aplikohet/printohet gazeta (letër, etj.);
- të përshtatë gazetën sipas kërkesës së klientit;

- të respektojë standartet për dizenjimin e gazetës;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike për punën e kryer;
- të komunikojë në mënyrë korrekte dhe prezantojë dizajnin klientit;
- ruajtja e dokumentit në indizajn.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 3 Kursanti kryen faqosjen e revistës në indizajn.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë llojet dhe vecoritë e revistave;
- të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të revistave;
- të bëjë kërkime në internet rreth revistës që do të dizajnoj;
- të analizojë revistën që do të dizajnojë;
- të krijojë një publikim të ri;
- të hapë dokumentat e dhura për dizenjimin e revistës;
- të përdorë kutinë e mjeteve të punës për zhvillimin e revistës në indizajn;
- të përdorë paletat e kontrollit për zhvillimin e revistës, në indizajn;
- të menaxhojë paletat e kontrollit gjatë zhvillimit të revistës në indizajn;
- të përdorë guidat e vizoreve për zhvillimin e revistës në indizajn;
- të përdorë guidat e anëve dhe kolonave për zhvillimin e revistës në indizajn;
- të bëjë zmadhimin dhe zvogëlimin e figurës për zhvillimin e revistës në indizajn;
- të bëjë zhvendosjen e figurës për zhvillimin e revistës në indizajn;
- të anultojë veprimet kur është e nevojshme për zhvillimin e revistës në indizajn;
- të përdorë të gjitha komandat e dhura për formatimin e tekstit për zhvillimin e revistës në indizajn;
- të kryejë veprimet bazë në përpunimin e tekstit për zhvillimin e revistës në indizajn;
- të strukturojë paragrafet e tekstit për zhvillimin e revistës në indizajn;
- të vendosë imazhe në objekte për zhvillimin e revistës në indizajn;
- të kryejë veprime të tjera të menaxhimit të objekteve (ndryshimi i radhës së mbivendosjes, grupimi, radhitja dhe shpërndarja e objekteve);
- të punojë me ngjyrat në indizajn për dizenjimin e

gazetës (përdorimi i paletës Swatches (mostrat), përdorimi i paletës së ngjyrave, përdorimi i katalogëve të ngjyrave të gatshme, krijimi dhe aplikimi i gradiençave);

- të bëjë strukturimin përfundimtar të faqes në indizajn;
- të vendosë numrin e faqeve dhe përmbajtjen e revistës me anë të faqeve Master;
- të rishikojë dhe të bëjë korrigjimet e duhura të revistës para se të printohet;
- të ruajë kodet e ngjyrave të dizajnit të revistës para se të printohet;
- të përshkruajë përbërjen e materialeve në të cilat aplikohet/printohet revista (letër, etj.);
- të përshtatë revistën sipas kërkesës së klientit;
- të respektojë standartet për dizajnimin e revistës;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike për punën e kryer;
- të komunikojë në mënyrë korrekte dhe prezantojë dizajnin klientit;
- të ruajë dokumentin në indizajn.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 4 Kursanti kryen faqosjen e librit në indizajn.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë llojet dhe vecoritë e librave;
- të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të librave;
- të bëjë kërkime në internet rreth librit që do të dizajnojë;
- të analizë librin që do të dizajnojë;
- të krijojë një publikim të ri;
- të hapë dokumentat e duhura për dizajnimin e librit;
- të përdorë kutinë e mjeteve të punës për zhvillimin e librit në indizajn;
- të përdorë paletat e kontrollit për zhvillimin e librit në indizajn;
- të menaxhojë paletat e kontrollit gjatë zhvillimit të librit në indizajn;
- të përdorë guidat e vizoreve për zhvillimin e librit në indizajn;
- të përdorë guidat e anëve dhe kolonave për zhvillimin e librit në indizajn;
- të bëjë zmadhimin dhe zvogëlimin e figurave për zhvillimin e librit në indizajn;
- të bëjë zhvendosjen e figurave për zhvillimin e revistës në indizajn;
- të anullojë veprimet kur është e nevojshme për zhvillimin e

librit në indizajn;

- të përdorë të gjitha komandat e duhura për formatimin e tekstit për zhvillimin e librit në indizajn;
- të kryejë veprimet bazë për krijimin dhe përpunimin e tekstit për zhvillimin e librit në indizajn;
- të importojë tekstin në indizajn nga wordi;
- të strukturojë paragrafet e tekstit për zhvillimin e librit në indizajn;
- të vendosë imazhe në objekte për zhvillimin e librit në indizajn;
- të përdorë stilet e veçanta të paragrafeve dhe objekteve;
- të kryejë veprime të tjera të menaxhimit të shtresave (ndryshimi i radhës së mbivendosjes, grupimi, radhitja dhe shperndarja e objekteve);
- të punojë me ngjyrat në indizajn për dizenjimin e librit (përdorimi i paletës Swatches (mostrat), përdorimi i paletës së ngjyrave, përdorimi i katalogëve të ngjyrave të gatshme, krijimi dhe aplikimi i gradiencave);
- të vendosë përmbajtjen e librit dhe numrin e faqeve me anë të faqeve Master (master page);
- të bëjë strukturimin përfundimtar të faqes në indizajn;
- të rishikojë librin para se të printohet;
- të ruajë kodet e ngjyrave të dizajnit të gazetës para se të printohet ose publikim dixhital;
- të përshkruajë përbërjen e materialeve në të cilat aplikohet/printohet libri (letër, etj);
- të përshtatë librin sipas kërkesës së klientit;
- të respektojë standartet për dizenjimin e librit;
- të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike për punën e kryer.
- të komunikojë në mënyrë korrekte dhe prezantojë dizajnin klientit;
- të ruajë dokumentin (librin) në indizajn.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

Udhëzime për zbatimin e modulit	- Ky modul duhet të trajtohet në kabinetin kompjuterik. - Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegime të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete. - Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në indizajn, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. - Atyre duhet ti jepen detyra për të dizenuar gazeta, revista dhe libra. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me projektet që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë. - Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: - Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore. - Mjedisë reale të punës. - Kompjuter dhe programe. - Kataloge, rregullore, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

5. Moduli “Përgatitja e portofolit profesional ”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	PËRGATITJA E PORTOFOLIT PROFESIONAL	GD -05-19
Qëllimi i modulit	Një modul teoriko- praktik që i njeh kursantët me rëndësinë që ka përgatitja e portofolit profesional për punësim, si dhe i aftëson ata të përzgjedhin projektet e duhura, ti përmirësojnë, ti ruajnë në formatet e duhura.	
Kohëzgjatja e modulit	10 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e mesëm, të jenë mbi 18 vjeç, të kenë kryer Modulin 1 “Hyrje në profesionin e dizenujesit grafik”; Modulin 2 “Editimi, transformimi dhe retushimi i imazheve në fotoshop”;Modulin 3”Dizenjimi i produkteve për reklamim në ilustrator”; Modulin 4 “Faqesja e gazetës, revistës dhe librit në indizajn”.	

Rezultatet e të mësuarit (RM), dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti përshkruan vecoritë e përgatitjes së portofolit profesional. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë rëndësinë që ka marketingu i punës së tyre; - të përshkruajë rrjetet sociale profesionale që shërbejnë për marketingun e punëve të tyre; - të përshkruajë rëndësinë që ka përgatitja e portofolit origjinal profesional; - të përshkruajë programet e përshtatshme që përdoren për çdo projekt; - të përshkruajë mënyrat e duhura për ruajtjen e punimeve(portofolit). Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje - përgjigje me gojë - Pyetje - përgjigje me shkrim RM 2 Kursanti përgatit portofolin profesional. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përzgjedhë punimet e përshtatshme dhe origjinale; - të bëjë organizimin dhe sistemimin e punimeve të krijuara; - të prezantojë punimet e tij në eventet e përshtatshme; - të ruajë punimet në pajisjet dhe sistemet e duhura. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje - përgjigje me gojë - Vëzhgim me listë kontrolli
Udhëzime për zbatimin e modulit	- Ky modul duhet të trajtohet në kabinetin kompjuterik. - Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegime të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete. - Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në indizajn, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. - Atyre duhet t'u jepen detyra për të organizuar dhe sistemuar punimet e tyre. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me projektet që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë. - Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit.
Kushtet e	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të

**domosdoshme për
realizimin e
modulit**

sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Kompjuter dhe programe.
 - Kataloge, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-